

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Masa e arrestit ndaj Vlora Hysenit, reagon Edi Rama: Lirim i menjëhershëm nga detyra!
ADRESA	https://tpz.al/masa-e-arrestit-ndaj-vlora-hysenit-reagon-edi-rama-lirim-i-menjehershem-n-ga-detyra-i333616
BURIMI	tpz.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 05:03:38 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	22 shtator 2026, 13:44:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	3866791c22518c8968a5bed787c978ad71f1cfae15c5c1a3054a5175f157a7fe
TEKSTI	74b9b2a3e1d2100c7cb663b6da2fc4572ced15e42fd996455e18ba03cecbe45a
PAMJA	bffc2cea030f6cfbf202a06fca29e461249fdc19c45e31fe5c8a96ecd76808

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	7b992611f8176d58016d64d1422f2b245a1635319a6f63e6d041f164ae951056
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	4a111ad93b0774e4315d3f6f441e1591ae8aff5c47e01d9c0b726a490b4da86a
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/7b992611f8176d58016d64d1422f2b245a1635319a6f63e6d041f164ae951056>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

FLASH!

16:44 Dyshohet se u ndërtua pa leje, sekuestrohet hoteli në Ksamil • 16:32 Makina përplasi motorin në zonën e Don Boskos, ndërron jetë 64-vjeçari • 15:44 Masa e arrestit

AKTUALITET, 22 SEPTEMBER 2026, 15:44

Masa e arrestit ndaj Vlora Hysenit, reagon Edi Rama: Lirim i menjëhershëm nga detyra!

tpz.al TPZ



Kryeministri Edi Rama, ka reaguar pas pezullimit dhe masës "arrest në shtëpi" ndaj kreut të inteligjencës shqiptare, Vlora Hyseni.

Hyseni dyshohet për "përkrahje të autorit të krimit" dhe "zbulim i akteve ose të dhënave sekrete" dhe ndaj saj u vendosën masat nga GJKKO, pas kërkesës së SPAK.

Rama njofton lirimin e menjëhershëm nga detyra të Hysenit dhe shton se sapo të kthehet nga SHBA do të emërohet kreu i ri i SHISH.

Reagimi i Kryeministrit:

Për shkak të orareve të ndryshme ky reagim nga Nju Jorku, ku jam për Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së, mund të duket i vonuar dhe ndjesë për këtë.

Jam informuar lidhur me masën e arrestit shtëpiak që SPAK-u ka nxjerrë për drejtoren e Shërbimit Informativ të Shtetit, e pres që çdo dyshim i organit të akuzës të hetohet dhe zbardhet deri në fund përmes procesit të pavarur gjyqësor.

Përtej respektit për punën dhe për personin e Vlora Hysenit, si edhe po ashtu përtej vlerësimeve të vazhdueshme, që ajo ka marrë nga agjencitë partnere si drejtuese e shërbimit inteligjent shqiptar, rruga pa kthim që kemi zgjedhur është rruga e pavarësisë së organeve të

ide!

Dënimet në Hagë, midis solidaritetit njerëzor ndaj të akuzuarve dhe keqkuptimeve alla shqiptare për drejtësinë

Nga Preq Zogaj

Vendimi i Gjykatës Speciale rrëzoi arsyet për të cilat ajo ishte ngritur


Nga Mero Baze

Tej e Këtej

Tronditet Edi Rama, i kërkohet largimi urgjent nga zyra brenda shtatë ditëve (letra)

Denonco!

Ke një lajm që do ta ndash me redaksinë e TPZ? Na shkruaj në Messenger ose [kliko këtu](#) për mënyra të tjera kontakti.



Moti

Tirana, Albania

WebTV



Ka frikë nga hetimet guvernatori?/ Ola Xama tregon pse i duhet super imuniteti Gent Sejkos

drejtësisë për të hetuar e gjykuar këdoqoftë, pavarësisht statusit social apo funksionit publik.

[Shiko të tjera video](#)

Por po ashtu, është e pashmangshme mesa duket, që çdo hetim apo masë e marrë nga drejtësia në adresë të personave publikë, të kthehet në një motivim për të grirë mish njeriu në mexhelisin politik e mediatik dhe për të thirrur "litarin" si në sheshet e ekzekutimit mesjetar, kohë përpara sesa gjykata të thotë fjalën e saj.

E megjithatë, kurrësesi nuk mund të jetë e vërtetë që veprimet e pavarura të drejtësisë dhe afirmimi i vijueshëm i barazisë para ligjit, të jenë njëkohësisht akt-akuza kundër pikërisht një shumice qeverisëse e cila me kurajo e me vendosmëri, ia ka çelur rrugën drejtësisë së pavarur, në një vend ku deri para shumë pak vitesh kjo pavarësi ishte e paimagjinueshme prej shekujsh.

As mund të jenë këto zhvillime me drejtësinë baltë kundër Shqipërisë, e cila po bën në rrugën e saj të bashkimit me Europën shumëçka që as nuk mund të imagjinohet akoma në vendet e tjera të rajonit dhe që koha do ta çmojë më mirë se sa kushdo.

Çdokush është i pafajshëm deri në gjykimin përfundimtar po askush nuk është mbi ligjin në asnjë rast e për asnjë arsye, kështu që unë i jam falenderues Vlora Hysenit për çdo gjë që ka bërë si duhet në shërbim të Shqipërisë, ndërsa për gjithçka tjetër që ka të bëjë me çështjen e sapohapur nga organet e drejtësisë, qëndrimi im mbetet po ai i ditës së parë të Reformës në Drejtësi:

Pafajësia ose fajësia e një bashkëpunëtori të vendosur nën akuzë është një çështje individuale përballë prokurorisë e gjykatës dhe kjo shumicë qeverisëse me mua në krye, i mbetet besnike këtij qëndrimi duke mos hyrë në meritën e asnjë çështjeje të drejtësisë dhe duke mos bërë avokatinë e askujt që përballlet me drejtësinë.

Lirimi nga detyra i drejtores së shërbimit është i menjëhershëm, e sapo të kthehem në Tiranë dhe në konsultim me Presidentin e Republikës, do të zgjedhim drejtuesin e ri të Shërbimit Informativ të Shtetit.

AKTUALITET / 22 September 2026, 15:42

Përplasi makinën me murin e banesës dhe dhunoi pronaren/ 54-vjeçari refuzon testin e alkoolit, arrestohet

AKTUALITET / 22 September 2026, 15:27

Ndryshon Kodi Doganor/ Më shumë lehtësi për bizneset, kufi për kamatvonesat

AKTUALITET / 22 September 2026, 15:20

Aksident i rëndë në Don Bosko, makina përplas motorin, drejtuesi rëndë në spital

AKTUALITET / 22 September 2026, 15:07

Konflikt mes dy nxënësve në Kukës, njëri lëndohet me thikë

AKTUALITET / 22 September 2026, 14:53

Reforma Territoriale/
Librazhdi voton pro bashkimit
me Prrenjasin, dështon
opozita në Këshillin Bashkiak

AKTUALITET / 22 September 2026, 14:47

Thatësira rrezikon mbjelljen e
grurit/ Fermerët në Fier:
Reduktojmë sipërfaqen

AKTUALITET / 22 September 2026, 14:39

Rikthehet rritja në tregun
valutor, forcohen monedha
kryesore

AKTUALITET / 22 September 2026, 14:21

Autorët vjedhin bronzin,
dëmtohet Memoriali i
Besëlidhjes historike të
Senicës në Delvinë

AKTUALITET / 22 September 2026, 14:04

Pensionit privat, nga 5 në 3
vjet/ Punonjësit fitojnë më
shpejt të drejtat mbi
kontributet

AKTUALITET / 22 September 2026, 13:55

Masa e sigurisë ndaj Vlora
Hysenit, SPAK njoftim zyrtar

AKTUALITET / 22 September 2026, 13:53

Nga Europa në Afrikë,
precedentët numërohen me
gishta: Sa i pazakontë është
arrestimi i Vlora Hysenit në
detyrë?

AKTUALITET / 22 September 2026, 13:46

Vendimi/ Apeli i Posaçëm lë
në fuqi masën "arrest me
burg" ndaj Ergys Agasit

AKTUALITET / 22 September 2026, 13:31

Operacioni/ Përndoqi ish të dashurën, e dhunoi dhe e kanosi, arrestohet 33-vjeçari në Tiranë! Kërcënoi edhe punëdhënësin e saj për ta hequr nga puna

AKTUALITET / 22 September 2026, 13:22

Raporti/ Paradoksi i popullsisë: Në Shqipëri linden më shumë djem por ka 28 mijë gra më shumë sesa burra

AKTUALITET / 22 September 2026, 13:15

PROFIL/ Kush është Vlora Hyseni, drejtuesja e SHISH që u pezullua nga detyra dhe u vendos nën arrest shtëpiak, me kërkesë të SPAK

AKTUALITET / 22 September 2026, 13:09

Lezhë, Koçiu: Dyfishohen pagesat për fëmijët me aftësi të veçanta, nga tetori do të paguhen kontributet e kujdestarëve

AKTUALITET / 22 September 2026, 12:59

Hyri për të grabitur në shtëpi, pronari vret shqiptarin, detaje nga jeta e 'dyfishtë' e Lazrit në Torino

AKTUALITET / 22 September 2026, 12:46

Masa e SPAK për Vlora Hysenin, Berisha: Nuk ndodh në asnjë vend që shefja e SHISH të jetë në shërbim të krimit! Vizitën e parë pas marrjes së detyrës e bëri në Beograd!

AKTUALITET / 22 September 2026, 12:35

AKTUALITET / 22 September 2026, 12:25

Skema/ Lehtësohen faturat e energjisë për klientët debitorë, ulen kamatëvonesat dhe firmosen 300 aktmarrëveshje në rajonin jugor

Sllloveni/ Ministri i Mbrojtjes, Nufi merr pjesë në Ministerialin e Bashkëpunimit të Mbrojtjes të Evropës Qendrore e Ballkanit Perëndimor